

UDHËZIM
Nr. 10, datë 3.4.2015

**PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË
PËRFUNDIM TË PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË
RREGULLUAR TË MËSUESIT**

(ndryshuar me udhëzimin nr. 23, datë 14.10.2019, nr. 24, datë 1.12.2023; nr.6, datë 24.4.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, pika 3 të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rreguluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 69/2102, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Pas përfundimit me sukses të provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit në *Qendrën e Shërbimeve Arsimore*, kandidatit i jepet licenca për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit, sipas profilit përkatës në fushën e mësuesisë.

2. Në mungesë të Urdhrit Profesional të Mësuesit, licenca lëshohet nga *Qendra e Shërbimeve Arsimore*.

3. Emërtimi i dokumentit të lëshuar pas përfundimit me sukses të Provimit të Shtetit në profesionin e mësuesit të jetë:

“Licencë për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit sipas profilit ku kandidati jep Provimin e Shtetit”.

4. Licenca për ushtrimin e profesionit rregulluar të mësuesit përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) Stemen e Republikës së Shqipërisë;
- b) Emërtimin “Republika e Shqipërisë”;
- c) Emërtimin “Ministria e Arsimit dhe Sportit”;
- d) Emërtimin “*Qendra e Shërbimeve Arsimore*”;
- e) Emërtimin e titullit profesional sipas pikës 3 të këtij udhëzimi;
- f) Emrin, atësinë dhe mbiemrin;
- g) Datëlindjen dhe vendlindjen;
- h) Bazën ligjore ku mbështetet dhënia e këtij dokumenti (ligji nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rreguluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar);
- i) Të dhëna për përfundimin e studimeve të ciklit të dytë “Masternë.....”;
- j) Datën e kryerjes së Provimit të Shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit;
- k) *Shfuqizuar* ;
- l) Nënshkrimin e Drejtorit të *Qendrës së Shërbimeve Arsimore* dhe vulën e AKP-së;
- m) Datën e lëshimit të licencës për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit;
- n) Numrin e licencës për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit.

5. Licenca për ushtrimin e profesionit rregulluar të mësuesit përmban një numër unik për çdo kandidat, i cili përbëhet nga dhjetë shifra, ku dy shifrat e para tregojnë vitin e dhënies së Provimit të Shtetit, dy shifrat e dyta kodin e profilit dhe gjashtë shifrat e tjera numrin individual të kandidatit, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. *Qendra e Shërbimeve Arsimore* përgatit licencën për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit sipas profileve përkatëse, me elemente të veçanta sigurie.

7. Të dhënat e kandidatëve plotësohen nga drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore sipas shtojcës 2 dhe dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe AKP.

8. Licenca për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit lëshohet nga AKP-ja brenda 45 ditëve

kalendarike nga data e përfundimit të Provimit të Shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit.

9. Licencat tërhiqen në *Qendrën e Shërbimeve Arsimore* nga personat e autorizuar nga DAR-et dhe mbahet procesverbali përkatës.

10. Një kopje e licencës ruhet në arkivin e *Qendrës së Shërbimeve Arsimore*.

11. Tërheqja e licencës bëhet pranë DAR-eve nga kandidatët fitues ose nga persona të pajisur me prokurën përkatëse.

12. *Qendra e Shërbimeve Arsimore* disponon në një regjistër kombëtar të dhëna të plota për pjesëmarrjen e kandidatëve në provimin e shtetit dhe për licencat, duke filluar që nga viti që provimi i shtetit është dhënë për herë të parë.

13. Modeli i licencave për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit është sipas shtojcës 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

14. Do të pajisen me licencë edhe të gjithë kandidatët e mëparshëm, fitues në Provimin e Shtetit për ushtrimin profesionit të rregulluar të mësuesit, të cilët janë kandidatët fitues të sezoneve të mëparshme të provimit të shtetit në këtë profesion, që nuk janë pajisur ende me licencë dhe konkretisht kandidatët pjesëmarrës dhe fitues në sezonet e provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit, dhjetor 2013 dhe korrik 2014.

15. Udhëzimi nr. 6, datë 24.3.2015, “Për përmbajtjen dhe formën e certifikatës/diplomës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit” revokohet.

16. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, *Qendra e Shërbimeve Arsimore* dhe drejtoritë arsimore rajonale/ zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA NR. 1

(ndryshuar me udhëzimin nr. 23, datë 14.10.2019, shtuar numri rendor 25, 26 me udhëzimin nr. 24, datë 1.12.2023)

Formimi i numrit unik të lejes për ushtrimin e profesionit të mësuesit.

1 4 0 1 0 0 0 0 0 1

Viti, kodi i profilit, numri individual

Viti: përbëhet nga dy shifra të cilat tregojnë vitin e dhënies së provimit të shtetit.

Kodi i profilit: përbëhet nga dy shifra të cilat tregojnë kodin e profilit.

Numri individual: përbëhet nga gjashtë shifra të cilat tregojnë numrin individual të kandidatit duke filluar nga 000001 dhe vazhdojnë në rend rritës.

Kodi sipas çdo profili në profesionin e mësuesit:

1. Gjuhë angleze, kodi 01;
2. Gjuhë italiane, kodi 02;
3. Gjuhë frënge, kodi 03;
4. Gjuhë gjermane, kodi 04;
5. Gjuhë greke, kodi 05;
6. Gjuhë shqipe dhe Letërsi, kodi 06;
7. Shkenca sociale, kodi 07;
8. Histori, kodi 08;
9. Gjeografi, kodi 09;

10. Histori-Gjeografi, kodi 10;
11. Histori-Gjeografi, Edukatë, kodi 11;
12. Matematikë, kodi 12;
13. Fizikë kodi 13;
14. Matematikë-Fizikë, kodi 14;
15. Informatikë, kodi 15;
16. Matematikë-Informatikë, kodi 16;
17. Kimi, kodi 17;
18. Biologji, kodi 18;
19. Biologji-kimi, kodi 19;
20. Edukim fizik kodi 20;
21. Arte figurative, kodi 21;
22. Muzikë, kodi 22;
23. Arsim fillor, kodi 23;
24. Arsim special, kodi 24;
25. *Arte skenike, kodi 25;*
26. *Koreografi, kodi 26;*
27. *Ekonomi, kodi 27.*

SHTOJCA NR. 2

(zëvendësuar me udhëzimin nr. 24, datë 1.12.2023)

[illegible]

SHTOJCA NR. 3

(zëvendësuar me udhëzimin nr. 24, datë 1.12.2023)

	
REPUBLIKA E SHQIPËRISË	
MINISTRIA E ARSIMIT	
DHE SPORTIT	
.....Qendra e Shërbimeve Arsimore	
<i>Licencë</i>	
PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT NË PROFILIN	
I lëshohet Z./Znj. në zbatim të	
(Emër, Atësi, Mbiemër)	(Datëlindja) (Vendlindja)
ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pas përfundimit	
të studimeve të ciklit të dytë Master në, kryerjes me	
sukses të praktikës profesionale dhe kalimit në provimin e shtetit në datën	
.....Drejtori i Përgjithshëm	
Data XX.XX.XXXX	Numri i licencës: XXXXXXXXXX